



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 11/5 Prot.

Tiranë, më 30.05.2022

V E N D I M

Nr.79, datë 30.05.2022

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë në procedurën e pranimit nga jashtë shërbimit civil, për pozicionet e punës me kod # 3709, Tiranë/Elbasan /Kukës/Vlorë/Berat/Fier/Dibër/Durrës/Fier, lloji i diplomës Shkenca Juridike, niveli minimal i diplomës “Bachelor” .

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenet 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 79 – 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e pranimit nga jashtë shërbimit civil, për grupin e pozicioneve të punës me kod # **3709**, Tiranë/Elbasan/Kukës/Vlorë/Berat/Fier/Dibër/Durrës/Fier, lloji i diplomës Shkenca Juridike, niveli minimal i diplomës “Bachelor”, të paraqitur nga kandidati *****,

VËREJ SE:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 11 prot., datë 05.01.2022 “Kërkesë për ndërhyrje në DAP, për të rishikuar rezultatin e vlerësimit”, shtetasi ***** , ka ngritur disa pretendime për parregullsi dhe shkelje të lejuara në zbatimin e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me procedurën e pranimit nga jashtë shërbimit civil,

për grupin e pozicioneve me kod # **3709**, Tiranë/Elbasan/Kukës/Vlorë/Berat/Dibër/Fier, lloji i diplomës, Shkenca Juridike, niveli minimal i diplomës “*Bachelor*”, për pozicionet e punës:

1. “*Specialist Jurist në Seksionin për Shërbimin Juridik, Psikologjik dhe Mjekësor, në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, në Drejtorinë Vendore të Tiranës*”, kategoria IV-b;
2. “*Specialist Jurist në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, në Drejtorinë Vendore të Elbasanit*”, kategoria IV-b;
3. “*Specialist Jurist në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, në Drejtorinë Vendore të Kukësit*”, kategoria IV-b;
4. “*Specialist Jurist në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, në Drejtorinë Vendore të Gjirokastrës*”, kategoria IV-b;
5. “*Specialist Jurist në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, në Drejtorinë Vendore të Vlorës*”, kategoria IV-b;
6. “*Specialist Jurist në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, në Drejtorinë Vendore të Beratit*”, kategoria IV-b;
7. “*Specialist Jurist në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier*”, kategoria IV-b;
8. “*Specialist Jurist në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, në Drejtorinë Vendore të Dibrës*”, kategoria IV-b;
9. “*Specialist Jurist në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, në Drejtorinë Vendore të Durrësit*”, kategoria IV-b;
10. “*Specialist Jurist në Sektorin e Burimeve Njerëzore në Repartin N.SH. Tiranë*”, kategoria IV-b;
11. “*Specialist Jurist në Sektorin e Burimeve Njerëzore në Repartin N.SH. Fier*”, kategoria IV-b;
12. “*Specialist Jurist në Qendrën e Furnizimit Materialo-Teknik*”, kategoria IV-b.

Për efekt të kryerjes së hetimit administrativ dhe për të qartësuar pretendimet mbi problematikën e paraqitur, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nëpërmjet shkresës nr. 11/1 prot., datë 31.01.2022, “*Kërkim dokumentacioni për verifikimin e pretendimeve të konkurrentit Bajram Milori, në lidhje me zhvillimin e procedurave të pranimit nga jashtë shërbimit civil, për pozicionet e punës me kod # 3709, Tiranë/Elbasan/Kukës/Vlorë/Berat/Fier/Dibër/Durrës/Fier, lloji i diplomës Shkenca Juridike, niveli minimal i diplomës “Bachelor”, drejtuar Departamentit të Administratës Publike, ka njoftuar fillimin e verifikimit të ligjshmërisë së këtij rasti, duke kërkuar njëkohësisht dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e tij.*”

Ndërkohë, me aktin nr. 11/2 prot., datë 08.02.2022, “*Dërgim materiale plotësuese*”, kandidati ***** ka dërguar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, dokumentacion shtesë për verifikimin e këtij rasti.

Njëkohësisht, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 11/3 prot., datë 14.02.2022, “*Kthim përgjigje*”, ka vënë në dispozicion gjithë praktikën e kërkuar nga Komisioneri, në lidhje me veprimet administrative të kryera.

Nga përmbajtja e akteve të vëna në dispozicion nga Departamenti i Administratës Publike dhe dokumentacioni që shoqëron kërkesën e paraqitur, rezulton e vërtetuar se konkurrenti ***** ka qenë pjesëmarrës në procedurën e konkurrimit për grupin e pozicioneve me kod #3709, – Lloji i diplomës “*Shkenca Juridike, niveli minimal i diplomës “Bachelor”* dhe nuk ka rezultuar fitues.

Konkurenti pretendon se, pasi është njohur me vlerësimin përfundimtar të Komitetit të Përhershëm të Pranimit, që e kishte vlerësuar atë me 67.6 pikë, brenda afatit ligjor ka bërë ankesë, mbi bazën e të cilës është rivlerësuar me 68.6 pikë, përfundim të cilin ai nuk e konsideron të drejtë dhe e kundërshton për arsyet e mëposhtme:

1. Në rivlerësimin e jetëshkrimit (*sipas tij, Komiteti i Përhershëm i Pranimit në këtë proces nuk ka marrë parasysh titullin avokat që disponon, por e ka konsideruar atë si certifikatë kualifikimi që tejkalon kërkesat për arsimin e kërkuar. Gjithashtu Komiteti nuk ka marrë parasysh as certifikatën të gjuhës e huaj, Italisht dhe as certifikatën për përdorimin kompjuterik. Sipas tij, këto certifikata duhet të merreshin parasysh nga Komiteti, si trajnime dhe jo si aftësi*).
2. Në rivlerësimin e testimit me shkrim (*sipas kandidatit, Departamenti i Administratës Publike në testimin me shkrim nuk ka formuluar saktë pyetjen 27, të këtij testimi*).
3. Në rivlerësimin e intervistës me gojë, (*kandidati pretendon se, nuk është dëgjuar dhe nuk është rivlerësuar inçizimi nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit, sepse sipas tij regjistrimi i intervistës është bërë me mjete personale, me celularin e nëpunëses e cila ka qenë pjesë e këtij Komisioni dhe jo me mjetet logjistike që disponon DAP për këtë fazë të testimit dhe për më tepër, sipas tij, njëra nga anëtarët e Komisionit, ***** , nuk ka qenë prezente për gjatë intervistës me gojë*).

Sipas ankuesit, ky fakt përbën shkelje të rëndë të detyrës nga ana e anëtares së komitetit dhe për pasojë nuk mund të konsiderohet i saktë rivlerësimi i intervistës me gojë.

Në kuadër të vlerësimit të pretendimeve të mësipërme, pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, rezulton e vërtetuar që, konkurrenti ******, ka qenë pjesëmarrës në procedurën e konkurrimit dhe pas seleksionimit paraprak nga ana e njësisë përgjegjëse, mbi plotësimin e kriterëve të përgjithshme dhe atyre të posaçme të përcaktuara në shpalljen e kësaj procedure, rezulton se kërkuesi në fjalë është kualifikuar për në fazën e dytë të konkurrimit, atë të testimit me shkrim.

Pas vlerësimit të jetëshkrimit nga KPP dhe korrigjimit të testimit me shkrim, kandidati është kualifikuar për fazën e intervistës së strukturuar me gojë e cila është zhvilluar në datën 03.12.2021, në ambjentet e DAP.

Sipas njësisë përgjegjëse, nga vlerësimi i intervistës së strukturuar me gojë dhe zhvillimit të saj, si dhe nga të dhënat e administruara nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP), bazuar në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, *“Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”*, të Departamentit të Administratës Publike dhe Kreun IV, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, i ndryshuar, kandidati është njoftuar për deklaratën mbi regjistrimin me zë të intervistës së strukturuar me gojë dhe ka zgjedhur që ajo të regjistrohet.

Gjatë intervistës, Komiteti i ka drejtuar konkurrentëve 5 pyetje të njejta, mbi fushën e njohurive të përcaktuar në shpallje dhe referuar përgjigjeve është vlerësuar individualisht nga secili anëtar i komitetit.

Bazuar në pikën 22, të Kreut IV, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”* i ndryshuar, njoftimi individual mbi rezultatet e vlerësimit përfundimtar për procedurën e konkurrimit në grup për shpalljen me kod # **3709**, *Tiranë/Elbasan/Kukës/Vlorë/Berat/Fier/Dibër/Durrës/Fier, lloji i diplomës Shkenca Juridike, niveli minimal i diplomës “Bachelor”*, është kryer në datën 09.12.2021, për të gjithë kandidatët që kanë marrë pjesë në këtë konkurrim.

Duke vazhduar më tej analizën e bazës ligjore rezulton se, pavarësisht faktit se kandidatët e përfshirë në këtë konkurrim kanë të drejtën për t’u ankuar në gjykatën administrative, kanë të drejtën gjithashtu, të bëjnë ankim me shkrim dhe në KPP, për rezultatin e pikëve dhe/ose të renditjes në listën fituese, sipas afateve të mëposhtme:

- a) data e njoftimit individual të rezultatit të vlerësimit me shkrim, për kandidatët që kanë grumbulluar deri në gjysmën e pikëve (deri në 30 pikë), nga ky vlerësim;
- b) data e njoftimit individual të rezultatit të vlerësimeve, për kandidatët që kanë grumbulluar deri në 45 pikë nga vlerësimi me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit;
- c) data e njoftimit individual të rezultatit të vlerësimeve, për kandidatët të cilët kanë marrë pjesë në të tre fazat e vlerësimit të përcaktuar sipas pikës 3, të Kreut VI, të këtij vendimi. Bazuar në pikën 6, të këtij vendimi, përcaktohet gjithashtu se, të gjithë ankesit marrin përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit ankimor.

Nga të dhënat e administruara rezulton se, kandidati *****, në datën 13.12.2021, ka paraqitur pranë DAP, ankesë me anë të cilës ka kërkuar rivlerësim të testimit me shkrim, jetëshkrimit dhe intervistës të strukturuar me gojë dhe në datën 14.01.2022, ka paraqitur kërkesë nëpërmjet të cilës ka kërkuar një kopje të deklaratës së regjistrimit të intervistës me gojë dhe inçizimin e regjistruar.

Komiteti i Përhershëm i Pranimit, është mbledhur në datën 17.12.2021, për shqyrtimin e ankesave për procedurën me kod # **3709**, Tiranë/Elbasan /Kukës/Vlorë/Berat/Fier/ Dibër/ Durrës/Fier, lloji i diplomës Shkenca Juridike, niveli minimal i diplomës “Bachelor” dhe pas shqyrtimit të ankesës, ka njoftuar kandidatin me përmbajtjen e procesverbaleve përkatëse të mbajtura nga KPP, si dhe i është vënë në dispozicion një kopje e deklaratës së regjistrimit të intervistës me gojë shoqëruar me inçizimin përkatës, sipas kërkesës të paraqitur prej tij.

Nga procesi i verifikimit dhe rivlerësimit të kryer, situata rezulton si më poshtë:

Së pari, në lidhje me vlerësimin e testimit me shkrim, Komiteti i Përhershëm, ka verifikuar dhe rivlerësuar materialet e administruara në ditën e testimit:

- Procesverbalin e paraqitjes në testimin me shkrim;
- Tezën e testimit;
- Fletët e skanuara të përgjigjeve të kandidatit, për testimin me shkrim.

Gjatë riverifikimit të materialeve të mësipërme, Komiteti i Përhershëm i Pranimit, nuk konstatoi asnjë pasaktësi, shënim apo ndërhyrje, që mund të çenojë vlefshmërinë e tyre.

Së dyti, në përgjigje të kërkesës së kandidatit lidhur me testimin me shkrim, pranë zyrave të Departamentit të Administratës Publike, u zhvillua një takim midis konkurrentit dhe përfaqësuesit të DAP, i cili i ka vënë në dispozicion, ankesit tezën e testimit me shkrim, fletën e përgjigjeve të testimit (*fleta e kuqe*) dhe raportin e prodhuar automatikisht nga sistemi i kompjuterizuar për vlerësimin e testimit me shkrim, i cili përmban informacionin mbi

përgjigjet e dhëna nga kandidati dhe përgjigjet e sakta. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të mësipërm kandidati ngriti pretendimin lidhur me testimin me shkrim dhe më konkretisht për pyetjen nr. 27.

Në lidhje me këtë pretendim, sipas procesverbalit të mbajtur në datën 16.12.2021, pranë ambjenteve të Departamentit të Administratës Publike, Komiteti i Përhershëm i Pranimit, sqaron se, pyetja ishte formuluar saktë por pasi analizoi përgjigjen e dhënë nga kandidati, u konstatua se alternativa e dhënë nga ana e tij, ishte e gabuar dhe për këtë arsye vlerësimi ka mbetur i njëjti.

Së treti, në lidhje me vlerësimin e jetëshkrimit, Komiteti i Përhershëm i Pranimit, ka sqaruar se, vlerësimi i elementëve të jetëshkrimit (*arsimi, eksperiencia, trajnimet e lidhura me fushën*), janë realizuar bazuar në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 të Departamentit të Administratës Publike, duke mbajtur në konsideratë kërkesat e posaçme që parashikohen në shpalljen për konkurrim dhe dokumentacionin e depozituar në dosjen elektronike të kandidatit.

Në këtë rast, Komiteti i Përhershëm i Pranimit, ka konkluduar se, vlerësimi i arsimit i lidhur me pozicionin, ka qenë 3 pikë, nga 5 maksimalja, për tejkalim të kërkesave.

Kandidati në këtë rast, ka ngarkuar në dosjen elektronike diplomën e studimeve të nivelit “*Master Shkencor në Drejtësi*”, ndërkohë që referuar shpalljes nr. 3709, niveli maksimal i kërkuar është zotërimi i një diplome të një niveli “*Bachelor në Shkenca Juridike*”.

Sipas Udhëzimit nr. 2, datë 27.03.2015 të Departamentit të Administratës Publike, kandidati vlerësohet me 5 pikë, në rastin kur zotëron:

1. *Gradë arsimore shtesë (të përfunduar), ku përfshihen gradat shkencore (Doktor, Docent, Kandidat Shkencash etj.);*
2. *Diplomë shtesë që është veçanërisht e rëndësishme për institucionin.*

Në rastin konkret titulli “*Avokat*”, konsiderohet si një certifikatë që lejon ushtrimin e profesionit në fushën e mbrojtjes juridike, e cila prezumon dhe përvojën një vjeçare në profesion, por nuk është gradë arsimore shtesë apo diplomë shtesë, që të konsiderohet arsim i plotësuar. Për këtë arsye KPK ka arritur në përfundimin që vlerësimi të mbetet i njëjti, 3 pikë nga 5 pikë, maksimalja.

Së katërti, në lidhje me përvojën e lidhur me pozicionin, kandidati është vlerësuar me maksimumin e pikëve (5 pikë), pasi kishte më shumë se tre vjet eksperiencë në fushën e kërkuar.

Së pesti, në lidhje me trajnimet e lidhura me fushën, kandidati është vlerësuar me 1 pikë nga 5 pikë maksimalja, për plotësim të kërkesave. Komiteti i Përhershëm i Pranimit, ka sqaruar se, për këtë grup pozicionesh nuk kërkohej trajnim i lidhur me fushën dhe në dosjen elektronike të kandidatit, gjatë fazës së ankimimit është ngarkuar licenca e avokatisë. Nisur nga fakti i fundit, vlerësimi në lidhje me trajnimet ka ndryshuar, nga 1 pikë në 2 pikë, nga 5 pikë maksimalja. Gjithashtu, është sqaruar fakti se, certifikata e kompjuterit dhe gjuhëve të huaja nuk konsiderohen trajnime, por aftësi të fituara.

Në përfundim KPP sqaron faktin se edhe pas rivlerësimit të intervistës së strukturuar me gojë, është vlerësuar me 8,6 pikë, nga 25 të mundshme.

Nisur nga sa më sipër, pas shqyrtimit të ankesës së kandidatit *****, Komiteti i Përhershëm i Pranimit, ka vendosur se vlerësimi përfundimtar i kandidatit për konkurrimin në grupin e pozicioneve të punës me kod # **3709**, Tiranë/Elbasan /Kukës/Vlorë/Berat/Fier /Dibër/ Durrës/Fier, lloji i diplomës Shkenca Juridike, niveli minimal i diplomës “*Bachelor*”, është 68.6 pikë nga 100 pikë të mundshme.

Nga sa u parashtrua më sipër dhe nga analiza në tërësi e dokumentacionit të administruar arrihet në përfundimin se, veprimet e njësisë përgjegjëse dhe Komitetit të Përhershëm të Pranimit, janë kryer brenda kompetencës dhe në përputhje me kërkesat e parashikuara në pikën 3, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar dhe vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*” të ndryshuar.

Për këto arsye:

Në zbatim të nenit 15 pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, pika 2, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*” dhe neneve 16, pika 6 të Kreut III “*Procedura paraprake*”, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë:

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, filluar në bazë të informacionit të regjistruar me nr. 11 prot., datë 05.01.2022, të dërguar nga punonjësi *****, me objekt verifikimin e pretendimeve për parregullsi të kryera apo të lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, në lidhje me procedurën e pranimit nga jashtë shërbimit civil, për grupin e pozicioneve me kod # 3709, Tiranë/Elbasan/Kukës/Vlorë/Berat/Fier/Dibër/Durrës/Fier, lloji i diplomës Shkenca Juridike, niveli minimal i diplomës “*Bachelor*” dhe meqënëse në veprimet e njësive përgjegjëse dhe të Komitetit të Përhershëm të Pranimit nuk u gjetën veprime apo qëndrime të kundraligjshme, kjo çështje të arkivohet.
2. Të njoftohen për këtë vendim, njësia përgjegjëse njësia përgjegjëse (*DAP*) dhe kërkuesi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha